



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.969/14 prot.

Datë 09.06.2025

V E N D I M
Nr. 754/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.06.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 701/2025, datë 26.05.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-40437-03-07-2025, me objekt: “Loti 2 Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale për nevoja spitalore”, me fond limit 5,148,943.80 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 20-03-2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës.

Autoriteti kontraktor: Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës me adresë Lagjia nr.7, Kukës

Ankimues: BOE “O.E.S Distrimed” SHPK me NIPT K31520054N dhe “Euromed” SHPK me NIPT K71718012P dhe adresë Bulevardi “Bajram Curri”, pallati Kastrati, Tiranë

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “Aquarius Medical” SHPK me NIPT L81512021D dhe adresë TIRANE, Rruga Don Bosko, Blloku Nr.1, Shkalla Nr.3, Kati I, Nr.4.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 26.05.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 701/2025 ku vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e BOE “O.E.S Distrimed” SHPK dhe “Euromed” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-40437-03-07-2025, me objekt: “Loti 2 Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale per nevoja spitalore”, me fond limit 5,148,943.80 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 20-03-2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kukes.*
2. *Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e prokurimit dhe me rihapjen e saj të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “O.E.S Distrimed” SHPK dhe “Euromed” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2 Me shkresën nr. 1216 prot., datë 30.05.2025, protokolluar me tonën nr. 969/11 prot., datë 03.06.2025, autoriteti kontraktor Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës, informon se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.701/2025, datë 26.05.2025 për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-40437-03-07-2025, me objekt: “Loti 2 Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale per nevoja spitalore”, me fond limit 5,148,943.80 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 20-03-2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kukes. Bashkëlidhur autoriteti kontraktor ka dërguar edhe Formularin e Njoftimit të Anulimit të procedurës së prokurimit, me nr. 1215 prot., datë 30.05.2025.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1 Me shkresën nr. 1216 prot., datë 30.05.2025, protokolluar me tonën nr. 969/11 prot., datë 03.06.2025, autoriteti kontraktor Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës, informon se ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.701/2025, datë 26.05.2025 për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-40437-03-07-2025, me objekt: “Loti 2 Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale per nevoja spitalore”, me fond limit 5,148,943.80 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 20-03-2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës. Bashkëlidhur autoriteti kontraktor ka dërguar edhe Formularin e Njoftimit të Anulimit të procedurës së prokurimit, me nr. 1215 prot., datë 30.05.2025.

II.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor ka bashkëlidhur Formularin për Njoftimin e Anulimit të procedurës së prokurimit nr. 1215 prot., datë 30.05.2025, në përputhje me vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 701//2025, datë 26.05.2025.

II.3. Sa më sipër, autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës lejohet të vijojë me anulimin e procedurës në sistemin elektronik të prokurimeve.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 12.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me anulimin e procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-40437-03-07-2025, me objekt: “Loti 2 Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale per nevoja spitalore”, me fond limit 5,148,943.80 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 20-03-2025 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

